



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.09.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erjon Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Seancë dëgjimore me ish-inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë gjatë viteve 2006-2010, zonjën Teuta Baleta.
3. Seancë dëgjimore me inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, zonjën Elivar Golemi.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Agron Çela, Andrea Marto, Arben Çuko, Ervin Koçi, Evis Kushi, Gjovalin Kadeli, Ilir Xhakolli, Blerina Gjylameti, Gledjon Rehoveci, Luan Duzha, Majlinda Bufi, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu dhe Përparim Spahiu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Koço Kokëdhima, Edmond Spaho, Ridvan Bode, Albana Vokshi, Dashamir Shehi, Florion Mima, Jorida Tabaku, Liljana Elmazi, Sherefedin Shehu, Igli Cara.

Të ftuar:

Teuta Baleta - ish-inspektor i Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë gjatë viteve 2006-2010,
Elivar Golemi – inspektor i Përgjithshme i Bankës së Shqipërisë.

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe - Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Siç është lajmëruar edhe dje, komisioni do të vazhdojë sot një seancë dëgjimore në raport me funksionimin e Bankës së Shqipërisë dhe përputhjen e këtij funksionimi me ligjin.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës do të doja edhe për anëtarët e komisionit, meqenëse të gjithë pasditen e djeshme dhe në darkë vonë ka pasur tentativa për të delegitimuar punën e këtij komisioni, të përsëris edhe një herë se inspektorja e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë zonja Elivar Golemi, duhet të japë shpjegime në këtë komision në një seancë dëgjimore në bazë të nenit 80, pika 3 e Kushtetutës, ku thuhet qartësisht: “Drejtuesit e institucioneve shtetërore me kërkesë të komisioneve parlamentare japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për atë që sa e lejon ligji”. Besoj se ky nen i Kushtetutës është shumë i qartë për inspektoren e Përgjithshme të Bankës së Shqipërisë.

Në zbatim të nenit 80, pika 3 e Kushtetutës është neni 36, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, mbi bazën e të cilit vepron edhe Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, që thotë qartë: “Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarët e Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si edhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar dhe me shkrim”.

Të gjitha kushtet e pikës 1 të nenit 36 janë të ezauruara në këtë komision, ndërkohë neni 2 i ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” përcakton qartë se Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Zonja në fjalë është thirrur ekzaktësisht edhe në përputhje me këtë nen të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”. Neni 41 i ligjit “Për Bankën e Shqipërisë” përcakton qartë se cilat janë organet drejtuese, ku thuhet: “Banka e Shqipërisë organizon, drejtohen dhe kryen veprimtarinë e saj nëpërmjet këshillit mbikëqyrës, administratorëve që janë guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët, si edhe personeli siç përcaktohet në këtë ligj”. Ndërkohë që në nenin 54, në të tria pikat përcaktohet shumë qartë: “Inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë është në rangun e zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë”, ndërkohë që pika 3 përcakton detyrat për të cilat ne kemi kërkuar që inspektorja të jetë në një seancë dëgjimore për të raportuar mbi përmbushjen e tyre para këtij komisioni.

Dua të saktësoj qartë se në nenin 54 thuhet në mënyrë taksative: “Inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë propozohet, zgjidhet dhe shkarkohet vetëm nga Kuvendi”, dhe nga askush tjetër. Në funksion të kësaj pike dhe të faktit të provuar nga ky procesverbal, në bazë të së cilit zonja Elivar Golemi ka qenë pjesë e një seance dëgjimore një muaj më parë, këtu në sallën e Kuvendit, pa e kërkuar askush, qoftë unë si kryetar i komisionit, ashtu edhe anëtarët e tjerë të komisionit, madje ka marrë përsipër edhe t’u përgjigjet pyetjeve të deputetëve, po përsëris edhe njëherë kërkesën që zonja në fjalë në orën 11.30 të jetë në këtë komision.

Si pikë e parë e rendit të ditës për këtë mbledhje të sotme është një seancë dëgjimore me zonjën Teuta Baleta ish-inspektore e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë me mandat të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, e cila është ftuar të na japë shpjegime lidhur me përmbushjen e detyrës në këtë periudhë.

Dua të sqaroj se zonja Baleta nuk ka lidhje me ngjarjen e vjedhjes në Bankën e Shqipërisë siç është komentuar rëndom apo është keqkuptuar nga media, por është thirrur vetëm në cilësinë e një personi ekspert që ka ushtruar detyrën e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë me mandat të Kuvendit nga vitet 2005-2010.

Doja që zonja Baleta të fillonte parashtrësën e saj lidhur me detyrën e ushtruar gjatë këtyre viteve dhe të jetë e hapur për pyetje të drejtuara nga anëtarët e komisionit.

Zonja Baleta, faleminderit që pranuat ftesën e këtij komisioni!

Teuta Baleta – Përshëndetje!

Unë kam përgatitur dëshminë time sipas kërkesës së paraqitur nga Komisioni i Ekonomisë dhe do të dëshiroja ta lexoja atë deri në fund. Jam e hapur për çdo lloj pyetje për të cilën në parantezë, po ju them se do të përgjigjem për ato informacione që nuk janë të klasifikuara, për sa kohë që kjo seancë është publike.

I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë të komisionit, jam paraqitur sot në këtë seancë dëgjimore në përgjigje të kërkesës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat që në cilësinë e ish-inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2006-2010 të jap dëshminë time për përmbushjen e detyrës së ngarkuar me ligj, problemet në përmbushjen e saj, problematikat e zbuluara dhe të raportuara për funksionimin e Bankës së Shqipërisë, si edhe mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm në këtë institucion.

Inspektori i Përgjithshëm sikurse u tha edhe në komision emërohet nga Kuvendi i Shqipërisë me mandat 5-vjeçar, që duke u shprehur në mënyrë të sintetizuar ka për detyrë të drejtojë Komisionin e Auditimit të Brendshëm në bankën qendrore. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit të Përgjithshëm janë të rregulluara dhe të përcaktuara në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” të detajuar në rregulloren e Departamentit të Kontrollit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Këto dokumente përbëjnë kuadrin ligjor bazë për organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm. Baza ligjore rregullative në tërësinë e vet është hartuar në frymën e standardeve ndërkombëtare të praktikës profesionale të auditimit të brendshëm.

Në momentin që kam marrë detyrën, objektivat kryesore ku e përqendrova punën, përveç detyrave ligjore, ishin të rritej shkalla e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe të përmirësoheshin aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm nëpërmjet programeve të dedikuara për trajnim. Përmbushja e këtyre objektivave do të ndihmonte në përmirësimin cilësor të ushtrimit të detyrës ligjore.

Në periudhën gjatë së cilës kam ushtruar këtë funksion, planet për përmbushjen e objektivave ligjore u hartuan mjaft të qarta dhe të përshtatshme, por zbatimi i tyre hasi në pengesa të konsiderueshme. Këto pengesa u ashpërsuan me kalimin e kohës, duke ndikuar negativisht në efektshmërinë e funksionimit të auditimit të brendshëm.

Për të qartësuar më konkretisht problematikën që e shoqëroi komisionin e auditimit të brendshëm, më lejoni të sqaroj në fillim, megjithëse mund të duket pak si trajtim teorik se, auditimi i brendshëm kufizohet si një veprimtari e pavarur, e theksoj këtë, sepse ka shumë rëndësi, që i jep siguri objektive dhe këshillime, dhe që është i projektuar në mënyrë të tillë, që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë operacionet e organizatës.

Auditimi i brendshëm e ndihmon organizatën të përmbushë objektivat e veta duke ushtruar një metodë të disiplinuar dhe sistematike që të vlerësojë dhe të përmirësojë efektivitetin e administrimit të rrezikut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes. Ky është një element tjetër shumë i rëndësishëm, pra të qeverisjes së institucionit. Ky nuk është një përkufizim i shpikur nga unë apo nga ndonjë kuadër rregullativ, por është kufizim që e japin standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm. Si i tillë auditimi ofron siguri të arsyeshme dhe këshillim për drejtimin, por nuk e zëvendëson në asnjë rrethanë punën e tyre. Për këtë arsye në standarde përcaktohet se auditimi i brendshëm duhet të jetë veprimtari e pavarur nga veprimtaria e përditshme e organizatës dhe përgjegjësia përfundimtare u mbetet drejtuesve

të çdo organizate. E njëjta vlen edhe për Bankën e Shqipërisë. Problematikat që e shoqëruan ushtrimin e funksionit të auditimit të brendshëm në bankën qendrore ishin disa dhe të rëndësishme.

Së pari, nuk u zbatua programi i propozuar për trajnimin e inspektorëve të Departamentit të Kontrollit që të përmirësoheshin aftësitë profesionale të tyre, një rekomandim që me forcë e kishte lënë edhe FMN-ja.

Që në fillim të detyrës kam kërkuar organizimin e trajnimeve afatgjata në formën e një shkolle të formimit profesional të përqendruara në tre module kryesore të rëndësishme për funksionimin e auditimit të brendshëm që janë: trajnimi me standardet e auditimit, me standardet kontabël dhe njohuritë statistikore.

Nëse do të keni më tej pyetje unë do t'ju sqaroj shumë mirë përse janë të rëndësishme njohuritë statistikore për inspektorët e kontrollit. Ky propozim nuk u zbatua asnjëherë deri në momentin kur unë e lashë detyrën.

Është mundur pjesëmarrja në programe trajnimi të ofruara nga banka të tjera qendrore, por ata nuk mund të përmbushnin nevojat që kishim identifikuar për trajnim. Kjo çështje nuk duhet të konsiderohet si një problem i rëndomtë trajnimi, por ka të bëjë me një nga aspektet themelore të punës së auditimit që është profesionalizmi i audituesve. Sa më i lartë të jetë ai, aq më shumë përforcohet pavarësia e audituesit të brendshëm.

Së dyti, pati vonesa në strukturimin e Departamentit të Kontrollit. Në cilësinë e drejtuesit të Departamentit të Kontrollit kam propozuar ristrukturimin e tij, me qëllim që të përforcoja auditimin e teknologjisë së informacionit për të reduktuar riskun e përqendrimit të njohurive dhe të përvojës tek një auditues i vetëm, sidomos në kushtet kur Banka e Shqipërisë po shtonte përdorimin e teknologjisë së informacionit, kam kërkuar të përforcoj pavarësinë e auditimit të brendshëm në aspektin juridik, të rris shkallën e zbatimit të standardit të auditimit të brendshëm për zbatimin e cilësisë së auditimit të brendshëm, nëpërmjet vendosjes së një filtri apo një shtrese të dytë vlerësimi të cilësisë.

Miratimi i strukturës së Departamentit të Kontrollit u vonua për një vit e gjysmë, pa dhënë asnjë shpjegim pse, dhe në kushtet kur Banka e Shqipërisë, nëse ndiqni vendimet që botohen të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me ndryshimin e strukturave organizative të Bankës së Shqipërisë, është një institucion që ka ndryshuar shpesh strukturat e veta, por nuk e gjeti të arsyeshme që po aq shpesh të ndryshonte edhe strukturën e Departamentit të Kontrollit.

Së treti, kam pasur mungesë të burimeve njerëzore, duke cenuar drejtpërdrejt kompetencën e inspektorit të Përgjithshëm për të propozuar inspektorët e Departamentit të Kontrollit.

Burimet njerëzore në këtë departament u kufizuan me disa veprime, nëpërmjet ndërhyrjes për largimin e inspektorëve pa propozimin e inspektorit të Përgjithshëm, një veprim (që nuk po e them këtu për herë të parë) e kam cilësuar dhe raportuar si: në kundërshtim me ligjin. Mosnisje e procedurave për plotësimin e vendeve të punës pasi Departamenti i Kontrollit u ristrukturua, vonesat në miratimin e riklasifikimit të inspektorëve, apo të nënshkrimit të akteve të emërimit për inspektorët e tjerë, kufizimi i burimeve njerëzore pati pasoja në ushtrimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, sepse e kufizoi nga ana sasiore punën që kryhej.

Me lëvizjet apo moslëvizjet e inspektorëve në kundërshtim me propozimet e inspektorit të Përgjithshëm, e theksoj u ndërhy në kompetencën e inspektorit të Përgjithshëm, u deformua raporti i tij me inspektorët vartës në funksionim të cenimit të pavarësisë së auditimit të brendshëm.

Së katërti, u kufizua aksesimi në informacion deri në pengimin total të tij, si edhe u mor përsipër interpretimi nga ana e njësive të audituara nëse informacioni që na jepej ishte i mjaftueshëm apo jo për inspektorët e kontrollit. Nga njësitet e ndryshme që auditoheshin na kufizohej dhënia e informacionit për inspektorët e kontrollit ose nuk jepej fare ai, gjë që është totalisht në kundërshtim me bazën ligjore dhe rregullative përkatëse dhe cenim i drejtpërdrejtë i standardeve të auditimit. Për më tepër merrej përsipër edhe interpretimi i faktit nëse informacioni që na ishte servirur ishte apo jo i mjaftueshëm për ne që të arrinim në konkludime.

Kërkoj të sjell në vëmendjen tuaj që elemente thelbësore të pavarësisë së funksionimit të auditimit të brendshëm janë: së pari, planifikimi i punës audituese pa ndërhyrjen e strukturave ekzekutive, aksesimi i lirë dhe pa kufizim, në çdo kohë dhe në çdo informacion që ka lidhje me objektin e auditimit, grumbullimi i evidencës audituese deri në atë masë sa gjykohet e mjaftueshme për të mbështetur konkluzionet pa u diktuar kjo gjë nga struktura ekzekutive, kryerja e testeve në terren për të verifikuar funksionimin e kontroleve të brendshme, të përcaktuara dhe të zbatuara në mënyrë të pavarur nga strukturat ekzekutive. Vetëm mbi këtë bazë audituesit janë në gjendje të formojnë dhe të shprehin opinionet e tyre në mënyrë të pavarur.

Ky funksion thelbësor u cenua pikërisht nga qëndrimet që shpjegova më lart dhe njëherësh u cenuan kompetencat e inspektorit të Përgjithshëm si i vetmi autoritet i përcaktuar me ligj, rregullore dhe me standarde ndërkombëtare për të organizuar, drejtuar, miratuar planifikuar dhe vlerësuar funksionin e auditimit të brendshëm.

Së pesti, mosmarrja e përgjegjësisë së pranimi të rrezikut nga ana e drejtimit të Bankës së Shqipërisë. Çfarë nënkuptojmë me këtë? Që auditimi i brendshëm të jetë një funksion efektiv duhet që

drejtimi i institucionit të shprehet mbi nivelin e pranimi të rrezikut. Një mekanizëm që i shërben këtij procesi është qëndrimi ndaj rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Në këtë aspekt, drejtimi në Bankën e Shqipërisë nuk e ndërtoi mekanizmin e pranimi të rrezikut. Për rrjedhojë, nuk kishte vendimmarrje në rekomandimet e auditimit të brendshëm, gjë që shërbeu si nxitës për njësitë në Bankën e Shqipërisë të shtonin shkallën e kundërshtimit dhe të moszbatimit të rekomandimeve *de facto*, duke i shndërruar këto struktura ekzekutive në struktura vendimmarrëse. Pra, u deformua raporti vendimmarrje-ekzekutim.

Për të gjitha këto problematika që prekën pavarësinë e auditimit të brendshëm, si dhe kompetencat e inspektorit të Përgjithshëm dhe dhanë ndikim negativ në funksionin e tij, me tendencë dobësimin, është raportuar për çdo herë te Guvernatori dhe Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë si në mbledhjet e rregullta që janë zhvilluar, ashtu edhe në takimin special që mbante inspektori i Përgjithshëm vetëm me anëtarët joekzekutivë të këtij Këshilli.

Fakti që problemet mbetën të pazgjidhura, madje u përkeqësuan deri në momentin kur kam lënë detyrën, në opinionin tim është pasojë e dështimit të Këshillit Mbikëqyrës, si organi më i lartë mbikëqyrës dhe vendimmarrës për të përmbushur rolin e mbikëqyrësit të strukturave ekzekutive.

Këtu dua të sqaroj se kur i referohem dështimit të funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës, i referohem si një organ kolektiv vendimmarrës i Bankës së Shqipërisë dhe nuk cenoj aspak profesionalizmin e çdo individi që është anëtar i këtij Këshilli, sepse, për hir të së vërtetës, brenda në Këshill ka pasur anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët e kanë ngritur zërin. Gjithsesi, zëri nuk u ngrit asnjëherë me forcën e duhur që këto probleme të zgjidheshin.

Gjatë veprimtarisë pesëvjeçare kam drejtuar auditimin e të gjitha funksioneve dhe proceseve të identifikuar në Bankën e Shqipërisë. Problemet e vërejtura kanë qenë të shumta dhe shpeshherë edhe kritike, nga sistemet e pagave dhe shpërblimeve në fondin e pensioneve, në veprimtarinë e kreditimit për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, në sistemet e sigurisë së informacionit dhe të sigurisë së ambienteve fizike, sistemet kontabël dhe transferimit të fitimit të Bankës së Shqipërisë në buxhetin e shtetit, veprimtarinë e punësimit dhe trajtimit të konfliktit të interesit, prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, të buxhetimit, të planit të investimeve, të zbatimit të kontratave e të tjera. Madje është evidentuar edhe problematika e deformimit të funksioneve të Këshillit Mbikëqyrës, siç është rasti, dhe këtë mund ta them, sepse është rast publik, i angazhimit të Këshillit Mbikëqyrës në procese prokurimi, duke marrë atributet e entit prokurues dhe duke humbur funksionin e tij mbikëqyrës.

Për këtë problematikë është lënë një numër i konsiderueshëm rekomandimesh. Të gjitha problemet e evidentuara dhe rekomandimet e dhëna janë raportuar edhe në Këshillin Mbikëqyrës, edhe në administratorët e Bankës së Shqipërisë, por edhe ky aspekt i veprimtarisë së auditimit përgjithësisht është shoqëruar me heshtje, pa u materializuar në vendimet që duhej të dilnin për zbatimin e rekomandimit. Për këtë arsye një numër i konsiderueshëm rekomandimesh mbetën pa u zbatuar, gjë që e dobësoi më tej efektivitetin e funksionimit të auditimit të brendshëm.

Më lejoni të shpreh edhe disa konsiderata shtesë, të cilat i gjykoj të nevojshme dhe madhore në gjithë këtë proces që po lidhet me Bankën e Shqipërisë.

Së pari, prej dhjetorit të vitit 2005, pra prej rreth 9 vjetësh, më shumë sesa periudha e një mandati të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, këtij institucioni i ka munguar zëvendësguvernatori i dytë, përgjegjës për mbikëqyrjen e disa njësive në Bankën e Shqipërisë. Edhe ky është një fakt publik, pra nuk po shkel asnjë lloj rrethane të klasifikimit të informacionit. Ky fakt përbën dobësim të sistemit të kontrollit, për shkak se kufizon vendimmarrjen ekzekutive dhe përqendron kompetencat. Njëherësh padrejtësisht edhe ai ekspozon kundrejt një rreziku më të lartë zëvendësguvernatorin e parë, i cili merr përsipër kompetencat e zëvendësguvernatorit të dytë që, përveç kompetencave të veta mjaft të gjera, ai duhet të ushtrojë edhe një mori kompetencash të tjera të një natyre krejt të veçantë. Në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje ligji, dhe këtë e kam shprehur edhe para Këshillit Mbikëqyrës, si dhe në cenim të autoritetit të Kuvendit, i cili ka përcaktuar që Banka e Shqipërisë të drejtohet nga tre dhe jo nga dy administratorë.

Së dyti, duke cenuar pavarësinë e auditimit të brendshëm dhe kompetencat e inspektorit të Përgjithshëm, është prekur një ndër shtyllat e rëndësishme që përbëjnë qeverisjen e një institucioni, të cilën e përmenda në rastin e dhënies së përkufizimit të auditimit të brendshëm, gjë e cila çon në dobësim të mjedisit të kontrollit dhe është e njohur teorikisht edhe me praktika të tjera të institucioneve homologe, që dobësimi i mjedisit të kontrollit çon në premisa për të prodhuar keqfunksionime, dështime të funksioneve dhe proceseve, keqbërje apo deri edhe skandale. Njëherësh është dobësuar përgjegjshmëria institucionale e Bankës së Shqipërisë. Duke dobësuar përgjegjshmërinë, është krijuar terreni që edhe pavarësia e bankës qendrore të dobësohet dhe të jetë më e cenueshme.

Këto konsiderata që thashë nuk përbëjnë trajtime të huazuara nga teoria. Ato kanë të bëjnë pikërisht me raportin optimal që duhet të ruhet ndërmjet pavarësisë dhe përgjegjshmërisë, me qëllim që të dyja elementet të përforcojnë njëra-tjetrën.

Në këtë aspekt, më lejoni të sqaroj tashmë jo në cilësinë e një ish-inspektoreje të Bankës së Shqipërisë, por me cilësinë e një punonjësi që ka një karrierë të gjatë në bankën qendrore, madje në sektorët më të rëndësishëm të saj; mos ma merrni për mungesë modestie, por edhe në cilësinë e një autoreje të një numri të lartë studimesh mbi pavarësinë institucionale dhe në veçanti të bankës qendrore.

E them me bindje të plotë se pavarësia e bankës qendrore mund të konsiderohet si një ndër shenjtëritë e ndërtimit institucional të saj.

Banka e Shqipërisë funksionon duke pasur një ndër ligjet më të mira nga pikëpamja e pavarësisë që i siguron dhe për këtë rrethanë ligjvënësi shqiptar, pavarësisht nga ngjarjet, nuk duhet të pendohet që ia ka ofruar këtë pavarësi.

Ky ligj, shkalla e konsiderueshme e pavarësisë së njohur sipas dispozitave të tij, përbëjnë një pasuri në kuptimin e ndërtimit të institucioneve të pavarura në Shqipëri dhe vetë funksionimit të demokracisë. Pavarësia njëherësh e ka ndihmuar Bankën e Shqipërisë që në vite të arrijë të formësojë praktika dhe funksione, si dhe të ketë rezultate të dobishme për ekonominë dhe tregjet financiare të vendit. Por ka ende nevojë të garantohet pavarësia reale e institucionit dhe kjo gjykoj se tani do të duhet të arrihet nëpërmjet forcimit të përgjegjshmërisë, për të treguar në publik se me pavarësinë nuk mund të abuzohet.

Bankat qendrore kudo në botë kanë aleat të parin publikun dhe këtë aleat e sigurojnë nëpërmjet veprimtarisë së tyre të përgjegjshme.

Pa dashur të diktoj asnjë proces të mëpasëm që mund të ndërmarrë ky komision apo institucione të tjera, e gjykoj të vlefshme të shprehem se në forcimin e përgjegjësisë do të duhet të përqendrohet çdo nismë që mund të ndërmerret për ndryshime ligjore. Në veçanti, duhet të formësohet dhe të forcohet lidhja ndërmjet inspektorit të Përgjithshëm dhe organit emërues, që është Kuvendi. Kjo do t'i shërbejë kufizimit të mundësisë që në të ardhmen të përsëriten situata të tilla.

Për hir të së vërtetës, nëse Kuvendi i Shqipërisë nuk do të kishte qëndruar në heshtje ndaj informacioneve të dërguara nga inspektori i Përgjithshëm, ndoshta sot nuk do të lindte nevoja që edhe unë të paraqisja këtë dëshmi.

I nderuar zoti kryetar i komisionit dhe deputetë anëtarë,

Dëshminë e paraqita në përmbushje të detyrimit ligjor kundrejt Kuvendit të Shqipërisë, në përmbushje të detyrimit moral ndaj taksapaguesve shqiptarë, por sidomos, dhe këtë e theksoj, në respektin pa kufi që kam për atë grup të vogël audituesish të Bankës së Shqipërisë dhe personelit ndihmës të inspektorit të Përgjithshëm, të cilët, pavarësisht rrethanave të rënduara, të krijuara gjatë

periudhës kur unë e kam drejtuar funksionin, pavarësisht uljeve nga detyra, largimeve nga detyra deri në pushimin nga detyra, punuan me përkushtim dhe e theksoj me integritet të papërlyer.

Duke shpresuar që të kem dhënë një dëshmi të plotë dhe të qartë sipas kërkesës së paraqitur, unë ju falënderoj për vëmendjen!

Erion Braçe – Shumë faleminderit, zonja Baleta, për gjithë ekspozenë që paraqitët në këtë komision jo vetëm për punën tuaj, por edhe për ta ndihmuar këtë komision në ecurinë e mëtejshme, veçanërisht në respekt të pavarësisë së bankës, të forcimit të ligjit dhe natyrisht edhe të institucioneve të tjera, siç është edhe kontrolli i brendshëm në Bankën e Shqipërisë!

Kalojmë në pyetje për secilin nga deputetët që dëshiron të adresojë pyetje përkundrejt zonjës Baleta.

Po e filloj unë i pari.

Zonja Baleta, ne si komision kemi mundur të administrojmë vetëm raportin e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010, në atë kohë kur ju keni qenë inspektore e Përgjithshme e bankës dhe keni drejtuar Departamentin e Kontrollit. Në këtë raport gjej një sërë problematikash që edhe ju i prekët praktikisht, por do të donim të kuptonim pak më shumë.

Një nga pikat e rëndësishme të këtij raporti auditimi janë problemet për veprimtarinë e auditimit dhe kjo na ka shqetësuar sinqerisht të gjithëve si komision. Është shumë shqetësuese edhe nga ato që artikuluat ju.

Pyetja e parë që kam është: ju konkludoni në këtë raport që keni punuar vetëm me 38% të forcës së punës. Do të doja të dija, kjo ka ardhur si rezultat i pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore në treg, apo kapërcimit të kompetencave të ekzekutivit të Bankës së Shqipërisë në plotësimin e strukturës dhe në përzgjedhjen e audituesve të këtij Departamenti të Kontrollit?

Së dyti, ju thoni në raport se ndryshimet strukturore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës që në vitin 2009 nuk u reflektuan nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Kjo gjë ishte kompetencë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore? Pra, a e ka tejkaluar kompetencën e saj Drejtoria e Burimeve Njerëzore në këtë aspekt?

Së treti, ju thoni në raport se audituesit janë kufizuar në shfrytëzimin e të drejtës së informacionit. A është edhe ky një tejkalim i kompetencës së ekzekutivit të bankës, në këtë rast i përgjegjësve të departamenteve e me radhë në kufizimin e informacionit për të kryer detyrën nga ana e audituesve?

Pyetja e katërt që kam ka të bëjë me shqetësimet që ju keni ngritur dhe riskun që i vinte bankës pikërisht nga mënyra sesi janë kryer blerjet në vlera të mëdha. Unë do të doja të isha pak më i qartë nga pikëpamja ligjore. Procedura ka qenë e mbështetur në ligj në raste specifike, apo jo?

Së fundi, në konkluzionet e raportit gjej këtë konkluzion tuajin: “Siç shihet, funksionet, proceset me shkallë të lartë rreziku ose sistem kontrolli më të dobët vlerësohen të jenë: administrimi i rezervës valutore, përfitimi i mallrave dhe shërbimeve me vlerë të madhe, përfitimi i mallrave dhe shërbimeve me vlerë të vogël, menaxhimi i sigurisë së informacionit, siguria e sistemeve dhe menaxhimi i mjedisit fizik të tyre, si dhe plani i vijueshmërisë së aktivitetit në fund dhe buxhetimi.” Dua të di, i cilit nivel ka qenë risku i bankës nga këto funksione?

Vazhdojmë me përgjigjet dhe pastaj bëjmë pyetjet e tjera.

Teuta Baleta – Po e filloj me pyetjen e parë: pse ndodhi pamjaftueshmëria? Kjo ka ardhur jo sepse në treg mungonin specialistët, por, siç e theksova, për dy arsye.

E para, sepse për postet shitesë që u krijuan si pasojë e ristrukturimit të Departamentit të Kontrollit, nuk u hapën asnjëherë procedurat e punësimit, pavarësisht kërkesës sime.

E dyta, për shkak se në mënyrë të njëanshme janë larguar nga detyra e inspektorit të kontrollit inspektorë, për të cilët unë nuk kisha propozuar që të largoheshin. Madje edhe kjo nuk përbën sekret. Janë larguar inspektorë që kishin integritetin për ta kryer atë detyrë, kurse ndërkohë nuk largoheshin inspektorë, për të cilët unë e kisha bërë një propozim të tillë. Kjo gjë bëri që të kufizohej forca e punës që unë kisha në dispozicion për të kryer detyrën. Dhe kjo është reflektuar gjerësisht në reduktimin e numrit të auditimeve që janë kryer gjatë një viti apo gjatë gjithë periudhës kur ka pasur këto kufizime në burimet njerëzore, gjë që nuk është kaq e thjeshtë, sepse ndikon në reduktimin e shkallës së auditimit në BSH. Pra, është një nga teknikat e cila ka bërë të pamundur të auditohen plotësisht funksionet e BSH-së.

Kjo është përgjigja për pyetjen e parë.

Pyetja e dytë në lidhje me tejkalimin e kompetencave. Siç e theksova në dëshminë që dhashë, nuk përcilleshin një pjesë e kërkesave të Departamentit të Kontrollit te nivelet vendimmarrëse, me qëllim që të mos mbetej faji te njësitë e BSH-së, sepse duhet të kuptojmë që kemi dhe një raport epror-vartës dhe do të ishte joefektive nga ana e Departamentit të Kontrollit që faji të vendosej te njësitë strukturore, të cilat kishin eprorë të tjerë mbi krye.

Gjithmonë kam informuar guvernatorin dhe Këshillin Mbikëqyrës për kërkesat që janë bërë, që nuk e kanë gjetur rrugën e tyre në Këshillin Mbikëqyrës. Nga ana e tyre dy autoritetet vendimmarrëse

kanë heshtur. Pra, edhe nëse mund të ketë ndonjë tejkalim kompetence nga ana e strukturave, përsëri faji s'mbetet aty, por ka një epror më të lartë. Për këtë arsye, edhe gjatë në dëshmisë që dhashë, e vendosa theksin te Këshilli Mbikëqyrës, si organi më i lartë vendimmarrës i BSH-së.

Së treti, është kufizuar informacioni. Edhe këtu e theksova se çdo kufizim i informacionit të kërkuar nga inspektorët e kontrollit për ushtrimin e auditimit, sa kohë që ata paraqesin një kërkesë për të audituar një program auditimi të firmosur nga inspektori i Përgjithshëm, përbën shkelje ligjore. S'është tejkalim kompetencash, por është shkelje ligjore dhe këtë shprehje unë e kam përdorur kudo në raportimet që kam bërë në institucionin e BSH-së.

Në lidhje me pyetjen e katërt kërkohej të dihej procedura specifike për blerjet.

Erion Braçe – Ju keni paraqitur në raport shqetësime për blerjet e mëdha.

Përmendët një rast që Këshilli Mbikëqyrës është marrë edhe me këtë aspekt (të prokurimeve, kur e ka me ligj të ndaluar ta bëjë këtë gjë). Desha të dija: veprimtaria për këto blerje ka qenë në përputhje me ligjin, apo jo? Gjithmonë, në gjykimin tuaj.

Teuta Baleta – Sipas ligjit bazë për BSH-në, kjo e fundit është një autoritet që i harton vetë rregullat e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve. Kuptohet që këto rregulla nuk bëhen jashtë një logjike të caktuar dhe në rekomandime është dhënë që ato të ndjekin frymën që ka ligji i prokurimeve. Ky rekomandim nuk është dhënë për të kufizuar pavarësinë e BSH-së, por unë kam studiuar edhe praktikatat e bankave të tjera qendrore, të cilat ndjekin frymën e ligjeve të prokurimeve publike të vendeve të tyre. Pavarësisht nga kjo, ajo që është vënë re, është që rregulloret në tërësi (këtë mund ta them sepse rregullorja është dokument publik), rregullorja e prokurimit të mallrave dhe shërbimeve, hartoheshin në mënyrë të tillë, që nuk siguronin sisteme kontrolli të mjaftueshme, me qëllim që të përmbusheshin parimet kryesore të tenderimit të mallrave dhe shërbimeve, që kanë të bëjnë me parimet e barazisë, efektivitetit të përdorimit të fondeve, objektivitetit dhe të tjera parime që janë në rregullore.

Në rregullore parashikohej e drejta e Këshillit Mbikëqyrës për të marrë vendime për prokurime të drejtpërdrejta dhe unë këtë e kam konsideruar si një cenim të sistemit të kontrollit, sepse organi që përcaktonte rregullat e kryerjes së këtij procesi, bëhej njëkohësisht pjesë e atij procesi. Kjo e deformonte deri diku raportin midis mbikëqyrjes dhe ekzekutimit.

Cili është risku i nivelit të funksioneve në BSH?

Mund të them se s'ka një risk të vetëm. Departamentit i Kontrollit në BSH përdor një metodologji për vlerësimin e riskut të funksioneve dhe proceseve. Në parantezë duhet të sqaroj që risku

apo rreziku s'është gjë e keqe. Ato janë të pranuar, janë risqe normale, të cilat ndërmerren në çdo veprimtari, që i ndërmerr çdo institucion apo organizatë. E rëndësishme, dhe prandaj ngrihen funksionet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe të kontrolleve të brendshme, është që të rrisë dhe të dihet se cilat janë, sa janë dhe a ka kontrolle të mjaftueshme, me qëllim, që këto risqe të mos kthehen në problematike.

Desha të sqaroj administrimin e reformës valutore. Në qoftë se ajo konsiderohet si një proces me rrezik të lartë, konsiderohet për shkak të kompleksitetit që ka si proces, por jo domosdoshmërisht është e keqe, sepse në atë proces mund të jenë vendosur kontrolle që janë të mjaftueshme dhe e bëjnë të kontrollueshëm rrezikun dhe nuk krijojnë rrethana për probleme të mëdha. Gjithmonë është parë në një lloj baraspeshimi nëse risqet që janë identifikuar gjatë procesit të vlerësimit, janë të përputhura edhe me kontrolle të mjaftueshme dhe nëse këto kontrolle funksionojnë apo jo. Për këtë arsye nuk ka një risk të përgjithshëm të vlerësuar që mund të themi për BSH-në. Është krijuar një hartë rreziku për të gjitha funksionet e BSH-së dhe njëherësh ajo është ballafaquar me hartën e kontrolleve që janë vendosur dhe që funksionon. Mbi këtë bazë ne bëmë një analizë të mëtejshme që Departamenti i Kontrollit duhet të kishte reaguar me planifikimin e detyrave në përputhje me këtë hartë rreziqesh dhe kontrollesh gjë që në konkluzion na doli që përgjithësisht kishim audituar më shpesh ato lloj funksionesh që kishin risqe më të larta dhe kontrolle më të pakta.

Erion Braçe – Zoti Xhakolli, keni fjalën! Më pas, zoti Marto!

Ilir Xhakolli – Duke u nisur nga eksperiencia juaj, a mendoni që ky numër specialistësh dhe me këtë shkallë profesionalizmit, e kishte të pamundur të zbulonte shkeljet që ndodhën në BSH?

E dyta, të gjitha këto shkelje që ndodhën atje janë vetëm për faj të auditimit të brendshëm?

Andrea Marto - Duke u nisur nga eksperiencia juaj në kohën kur ishit në pozicionin e inspektorese së Përgjithshme, problemet dhe shqetësimet e vërejtura nga ju në këtë kohë, buronin nga mangësitë ligjore, apo nga mangësitë në rregulloren e funksionimit të brendshëm të BSH-së?

Në vijim, përsëri nga eksperiencia juaj, gjykoni që janë të domosdoshme ndryshime në kuadrin ligjor dhe rregullativ të BSH-së?

Faleminderit!

Teuta Baleta – Numri i audituesve dhe profesionalizmi i tyre e bën të pamundur zbulimin e shkeljes. Unë e theksova që shkelje s'duhet të ndodhin dhe ky është parimi për të gjithë drejtuesit, punonjësit dhe kushdo në BSH ka për detyrë të punojë me korrektësi. Në një situatë ideale, edhe pa praninë e auditimit të brendshëm, s'duhet të ndodhin shkelje.

Auditimi i brendshëm nuk është për të zbuluar patjetër shkelje, sepse nuk ka këtë funksion thelbësor. Ai ka funksion thelbësor të forcojë sistemin e kontrollit të brendshëm, me qëllim që të mos krijohen risqe të tepruara për atë institucion, por të merren masa me kohë me qëllim që të kontrollohen risqet deri në kufizimin e mundësisë që të ndodhin shkelje.

Numri i audituesve përderisa u kufizua, vetvetiu kufizoi detyrën e auditimit të brendshëm. Nëse do të duhet të auditonim 12 funksione ose procese gjatë një viti, ne bëmë 38% të tyre. Kjo kufizon edhe funksionin tonë ndaj Këshillit Mbikëqyrës dhe mundësinë që ne t'i paraqesim rekomandime për përmirësimin e situatave aty ku ato nuk ishin të përshtatshme.

Në fund fare, auditimi me standard i brendshëm jep siguri të arsyeshme sepse, ai nuk është i pranishëm në njësitë ekzekutive 24 orë, për shtatë ditët e javës dhe prandaj e theksova që përgjegjësia është e njësisë ekzekutive. Auditimi i rekomandon si një funksion që është jashtë njësisë ekzekutive dhe mund ta shikojë më me objektivitet problematikën që mund të kenë këto njësi, për arsye se duke punuar çdo ditë, ambientohesh me të dhe ndonjëherë nuk je në gjendje të shikosh mangësitë dhe në këtë mënyrë, i rekomandon për ta përmirësuar këtë lloj situatë. Mbi të gjitha, auditimi e rrit efektivitetin e vet të punës dhe sidomos rrit shkallën e zbulueshmërisë së shkeljeve kur ka bashkëpunim të sinqertë, pra kur merr informacionin e kërkuar. Në momentin që këto informacione i kufizohen në mënyra të ndryshme, i jepen me vonesë, apo kufizohet deri edhe në ambjentet e punës që të vireshin në dispozicion për të punuar, atëherë, kjo është ndikim në cilësinë e auditimit të brendshëm.

Pyetjen nëse ishte faji i audituesve të BSH-së më duket se e sqarova.

Thashë që auditimi jep siguri të arsyeshme dhe nuk është polici i një institucioni që të mos lejojë që dikush të vërë dorën diku. Nëse një individ e ka qëllim të tij që të shkelë rregullat, të vjedhë apo të kryejë vepra të tjera të dëmshme, atëherë është e qartë që ai ose ajo (të mos e personalizoj nga ana gjinore), do të mundohet me të gjitha mënyrat që ta realizojnë këtë qëllim. Këtu pastaj është roli i institucionit, i drejtuesve, i kontrollit që duhet të ushtrohet, deri te auditimi i brendshëm.

Erion Braçe – E qartë, vazhdoni me pyetjet e tjera!

Teuta Baleta – *Shqetësimet burojnë nga mangësitë ligjore?*

Përsëri në opinionin tim s'është se BSH-ja ka mangësi ligjore të theksuara, të cilat sjellin të tilla shqetësime. Unë ia vë më tepër keqinterpretimit që iu bënë dispozitave ligjore, frymës së përgjithshme kundërshtuese ndaj auditimit të brendshëm dhe zgjidhjes së problemeve të auditimit të brendshëm dhe në këtë bazë, përderisa nuk ekziston mjedisi i nevojshëm etik dhe moral për zbatimin e rregullave dhe

dijeve, në të tilla rrethana je i detyruar të ndërhysh, duke i qartësuar dhe forcuar më shumë dispozitat ligjore dhe rregullative.

Ky është mendimi im.

Erion Braçe – Zoti Koçi, keni fjalën!

Më pas, zonja Gjylameti, zonja Bufi, zonja Kushi!

Ervin Koçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke falenderuar zonjën Baleta për informacionin dhe panoramën e plotë që na dha për Bankën e Shqipërisë, duke e zgjeruar të gjithë problematikën që është përtej asaj vjedhjeje prej 7 milionë dollarë, kam disa pyetje:

Në gjykimin tuaj, duke qenë një njohëse e mirë sesi funksionon Banka e Shqipërisë dhe problematikën që ajo ka, sa përgjegjës është guvernatori i BSH-së dhe Këshilli Mbikëqyrës për këtë ngjarje (gjithmonë, nëse dëshëroni të përgjigjeni)?

Pyetja e dytë ka të bëjë me kohën kur ju keni qenë inspektore e Përgjithshme: si ka qenë procesi i asgjesimit të parave që kanë dalë jashtë përdorimit nga bankat e nivelit të dytë?

Pyetja e tretë ka të bëjë me mënyrën sesi mbyllet bilanci kontabël dhe fizik për vitin ushtrimor të bankës. Drejtoria që ka pasur në administrim fizik vlerat monetare (kartmonedhat dhe monedhat metalike), a kishte detyrim për të kryer inventarizimin fizik, apo të paktën të drejtën për të kryer inventarizimin fizik të gjendjes së parave në fund të vitit?

Pyetja e katërt, e cila ka të bëjë me atë nëse ka të drejtë inspektori i Përgjithshëm që të fillojë të adaptojë administrimin dhe investimet që bëhen në rezervën valutore.

Teuta Baleta – Siç e theksova, këtu jam për të dhënë dëshmi jo në lidhje me ngjarjen që ka ndodhur, se nuk kam informacion në asnjë rrethanë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi këtë. Do të dëshiroja të mos shprehesh, sa kohë që unë, me këtë këshill mbikëqyrës aktual nuk është se kam pasur raporte pune, sepse jam larguar përpara se të konstituohet ky këshill dhe unë mendoj se nuk është shumë etike...

Erion Braçe – Kjo është shumë e qartë. Jeni në të drejtën tuaj në këtë pikë.

Teuta Baleta – Pavarësisht se mund të kem opinione, apo njërin e tjetrën...

Erion Braçe – Kjo është tjetër gjë.

Teuta Baleta – Por mendoj se nuk do të ishte etike nga ana ime sa kohë që nuk kam ndërvepruar.

Siguria e procesit të asgjësimit të parave. Këtu do të rezervohet të flas, sepse është një proces i cili klasifikohet si jopublik. Sigurisht, ka një procedurë që përcaktohet me urdhra. Urdhrat firmosen nga administratori, i cili e mbulon njësinë, përkatësisht departamentin e emisionit. Ka procedura numërimi, paketimi.

Erion Braçe – Më ndjeni që po ju ndërpres.

Teuta Baleta – Në kohën kur isha unë, asgjësimi bëhej me djegie. Tani, me sa kam dijeni, është ndryshuar kjo formë e asgjësimit dhe bëhet në një tjetër formë. Pra, nuk e di më se si organizohet procesi, me formën e re që është aplikuar. Gjithsesi këto janë informacione të klasifikuara.

Erion Braçe – Kam përshtypjen se shqetësimi i zotit Koçi është ky: dokumentohet i gjithë procesi, në çdo hap të tij?

Teuta Baleta – Patjetër që dokumentohet dhe duhet të dokumentohet.

Erion Braçe – Domethënë, baza rregullative parashikon dokumentimin e çdo hallke të këtij procesi?

Teuta Baleta – Për aq kohë sa kam qenë unë, po.

Erion Braçe – Faleminderit!

Teuta Baleta – Si mbyllej bilanci dhe ishte kryer inventarizimi? Rregullat tani, në mos gaboj, sepse kam një shkëputje prej katër vitesh...

(Diskutime pa mikrofon)

Sigurisht, por nuk mbahen mend të gjitha. Është një mori rregullash, që edhe ne i rifreskonim sa herë kishim auditivin, por kryhet inventarizimi, strukturat e bankës kanë detyrimin të ngrenë grupet e inventarizimit. Më duket se shpeshtësia është një herë në vit. Mund të jem edhe jo shumë e saktë në këtë informacion. Kryhej inventarizimi dhe patjetër ato rezultate duhet të pasqyroheshin në bilancin kontabël.

Ervin Koçi – ...që është përgjegjëse për administrimin e kartëmonedhave, e ka si detyrim ta bëjë vetë ajo, drejtori, drejtori përkatës, në strukturë, për të bërë inventarizimin fizik të gjendje së parave?

Teuta Baleta – E theksoj: çdo drejtues njësie, sado i vogël, pra, që nga përgjegjësi i zyrës, përgjegjësi i sektorit, drejtori e me radhë, deri te Këshilli Mbikëqyrës, kanë përgjegjësinë për të ushtruar kontrollë brenda objektivit që ata kanë, të përcaktuara në ligj e në rregullore.

Ervin Braçe – Jemi shumë të qartë.

Teuta Baleta – Administrimi dhe investimi i rezervës valutore, po, kanë qenë objekte të auditivit, por jo politika e rezervës valutore, sepse politika e investimit të rezervës valutore është atribut i Këshillit Mbikëqyrës dhe këtu pastaj cenonim pavarësinë e funksionit politikbërës.

Ervin Braçe – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Gjylameti, pastaj zonja Kushi dhe zonja Bufi.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe zonjës Baleta për disponueshmërinë, për informacionin që po na jep! Kisha një pyetje për sa i përket eksperiencës suaj, si dhe në gjykimin tuaj: a mund të tejkalohet bllokimi i dhënies së informacionit, sipas asaj që dëgjuam edhe në raportimin tuaj, nga drejtori të caktuar, apo, nga ana tjetër, sipas raportit të inspektorit aktual, në dërgimin e informacionit në Kuvendin e Shqipërisë? A mund të tejkalohet ky lloj bllokimi?

A ka ndonjë hapësirë me të cilën do të mund të tejkalohet ky lloj bllokimi nga ana e Këshillit Mbikëqyrës, në rastin e fundit, nga inspektori i përgjithshëm, nga raportimi i inspektorit të përgjithshëm aktual? Faleminderit!

Teuta Baleta – Standardet e auditimit janë shumë të qarta në këtë aspekt. Ato përcaktojnë që aksesit në informacion duhet të jetë i lirë, pa asnjë kufizim. Në momentin që kufizohet, audituesi ka të drejtën e tij të lëshojë opinion me rezervë ose të mos lëshojë opinion fare. Në këtë standard kemi zbatuar.

Pastaj, se strukturat ekzekutive drejtuese heshtën përpara këtij kufizimi, këtë ne nuk e tejkalonim dot. Nuk ishte në kompetencën tonë për ta tejkaluar. Thjesht duhet të zbatohet ligji.

Ervin Braçe – Faleminderit!

Fjala e ka zonja Kushi.

Evis Kushi – Zonja Baleta, shumë faleminderit për këtë analizë profesionale, që vërtet na ndihmon shumë për të qartësuar dhe për të kuptuar problematikat që kanë shoqëruar Bankën e Shqipërisë gjatë periudhës që ju keni qenë inspektore e përgjithshme, por që me shumë gjasa kanë vazhduar edhe përtej kësaj periudhe!

Unë kisha dy pyetje në lidhje me Bankën e Shqipërisë. Së pari, në një nga raportimet, madje në raportimin e fundit, që zoti Fullani ka bërë përpara këtij komisioni, raportimi në dhjetor për punën e Bankës së Shqipërisë, ka deklaruar se cilësia e stafit të Bankës së Shqipërisë është shumë e lartë, madje mbi mesataren evropiane. Në mënyrë eksplicite, kështu ka deklaruar.

Megjithatë, pas ngjarjes, shumë media kanë publikuar një listë të gjatë emrash, punonjësish, që kanë lidhje shumë të ngushta familjare me deputetë apo persona që kanë pushtet në Shqipëri. A ndani ju të njëjtin mendim, që cilësia e stafit ka qenë shumë e lartë dhe konkretisht, gjatë periudhës që ju keni qenë inspektore e përgjithshme, a janë respektuar procedurat dhe kriteret e punësimit? Përtej kësaj, a ka

pasur raste nepotizmi brenda Bankës së Shqipërisë, dhe a janë marrë masa, nëse janë konstatuar raste të tilla?

Pyetja e dytë që kam. Ligji parashikon se anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nuk duhet të ushtrojnë veprimtari politike gjatë periudhës që ushtrojnë detyrën si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, madje neni 47 i ligjit, pika “d”, domethënë pika 1/“d” parashikon që anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pezullohen nga detyra nga Këshilli i Ministrave dhe shkarkohen nga Kuvendi, në qoftë se gjatë ushtrimit të detyrës, në mënyrë aktive marrin pjesë në veprimtari politike. Gjatë periudhës që keni qenë ju, a ka pasur raste të tilla? A keni qenë të vëmendshëm ju, si Bankë e Shqipërisë, që të mos ketë raste të tilla?

Si për pyetjen e parë, ashtu edhe për pyetjen e dytë, a e cenojnë këto problematika pavarësinë që duhet të ketë Banka e Shqipërisë? Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi!

Po, zonja Baleta!

Teuta Baleta – Janë dy pyetje, të cilat në fakt e tejkalojnë pozicionin tim për t’u dhënë përgjigje. Jo se refuzoj apo kam frikë të jap përgjigjet. Për shembull, unë do të rezervohesha të shpreheshja për cilësinë e stafit, përderisa është bërë një koment nga ana e guvernatorit.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord, por më poshtë ishte pyetja: a ndani edhe ju të njëjtin mendim?

Unë kam mbuluar detyra të rëndësishme. Në vitin 1998 jam emëruar drejtore e Departamentit të Kërkimeve e të Politikave Monetare, që është një drejtori tepër e rëndësishme në bankën e Shqipërisë. Po flas për pjesën kur unë kam punësuar njerëz. Procesi i punësimit të profesionistëve ka qenë realisht një proces transparent, ku janë marrë punonjës me cilësi të lartë. Kjo cilësi vërtet ka vazhduar. Pra, nuk duhet ta transferojmë këtë gjë tani, këtë problem, nëse janë apo jo punonjësit me cilësi të lartë. Punonjësit, edhe po të mos jenë me cilësi të lartë, bëhen me cilësi të lartë nëpërmjet një procesi trajnimi të strukturuar dhe objektiv. Kjo është detyrë dhe Banka e Shqipërisë i ka burimet për këtë gjë.

A janë respektuar procedurat dhe kriteret?

Banka e Shqipërisë ka procedura dhe kriterë. Ne i kemi audituar, kemi nxjerrë problematikat tona në lidhje me to. Përsëri rezervohem të jap informacion më të detajuar për këtë gjë. Për çështjen e nepotizmit, gjithashtu e kemi audituar, në funksion të zbatimit të ligjit të konfliktit të interesit, kodit të etikës që ka Banka e Shqipërisë dhe detyrimeve që kanë punonjësit në Bankën e Shqipërisë për të bërë deklarimin e konfliktit të interesave private, pasurore e njëkohësisht edhe të lidhjeve familjare që ata

mund të kenë në Bankën e Shqipërisë. Për këtë kemi gjetur problematikën, proces-raportimin, të cilat i janë referuar Këshillit Mbikëqyrës. Këtu, përsëri nuk jap dot më detaje të mëtejshme, se çfarë problematikash janë përcaktuar.

Tani, edhe një herë dua të theksoj, jo në cilësinë e ish-inspektoreve të përgjithshme, por në cilësinë e një individi që ka punuar për 15 vjet në Bankën e Shqipërisë, të mos transferohen probleme që mund të jenë shfaqur nga drejtuesit, ose ngjarja e fundit, në një presion mbi punonjësit e bankës, nëse jeni ose jo të përshtatshëm për të punuar, sepse ata punojnë nganjëherë edhe në kushtet e presionit. Dhe ne e dimë të gjithë se presioni bëhet jo me rregulla, jo me procedura, por bëhet në mënyrë të heshtur, jo formale, që është shumë e vështirë edhe ta evidentosh, edhe t'i kundërvihesh.

Janë pikërisht kjo cilësi punonjësish, që deri diku e kanë mbajtur Bankën e Shqipërisë dhe ushtrojnë me profesionalizëm disa detyra të rëndësishme të saj.

Anëtarët nuk duhet të ushtrojnë veprimtari politike dhe a cenon pavarësinë e Bankës së Shqipërisë? Sigurisht, çdo angazhim në veprimtari politike përbën cenim të pavarësisë së bankës së Shqipërisë, sepse komprometon objektivitetin e vendimmarrjes.

Nëse anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë angazhuar apo jo, kjo nuk është objekt i inspektorit të përgjithshëm për ta audituar, por është çështje e autoriteteve që i propozojnë dhe i emërojnë anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.

Erion Braçe – Faleminderit edhe një herë!

Fjala për ju, zonja Bufi.

Majlinda Bufi – Faleminderit, kryetar! Faleminderit, zonjë, për prezencën dhe për atë shpjegim, besoj mjaft të dobishëm, jo vetëm për ne, por edhe për opinionin publik!

Ndaj të njëjtin mendim me ju, në lidhje me atë që thatë, që: pavarësia e Bankës, edhe pse Shqipëria ka ndoshta një ndër ligjet më të mira për bankën, nuk duhet të na lejoj të gjithëve që të bëjmë të mundur apo të heshtim përballë atyre ngjarjeve për abuzime të tilla, si ajo që ka ndodhur.

Unë kisha tri pyetje. Sigurisht që ju e ndani vetë nëse duhet t'u përgjigjeni pyetjeve apo jo.

Në deklarinimin e fundit që ka bërë këtu guvernatori i Bankës, dhe sipas pyetjeve që janë bërë nga ne, është thënë se nuk ka pasur kontroll fizik në bankë.

Teuta Baleta – Nuk ka pasur...?

Majlinda Bufi – Kontroll fizik të punonjësve, gjatë hyrjeve e daljeve. Nuk është procedurë, nuk zbatohet. Nuk ekziston sot.

Në opinionin tuaj, edhe si eksperte, si punonjëse apo në pozicionin e inspektore, që keni qenë, a duhet të jetë ky kontroll, apo jo?

Një pyetje tjetër: një nga rekomandimet që ju keni bërë gjatë punës suaj në Këshillin Mbikëqyrës është trajnimi i punonjësve të bankës, trajnimi më i specializuar, dhe që një pjesë e këtyre rekomandimeve tuaja nuk është marrë parasysh.

Mund të na thoni një opinion tuajin se përse nuk është marrë parasysh? Si e gjykoni ju këtë gjë? Dhe tjetra, më bën të dyshoj që personi që ka kryer vjedhjen rezulton me certifikatë të lartë sigurie. Si është e mundur kjo gjë?

Pyetja tjetër, pyetje e përgjithshme, sigurisht që ju, në fjalën tuaj, thatë diçka në lidhje me këtë pyetje që unë do të bëj, po për të qenë më e qartë unë dhe të gjithë ata që dëgjojnë: rekomandimet që ju i keni çuar Këshillit Mbikëqyrës apo edhe komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë, sa nga këto rekomandime janë marrë parasysh nga Kuvendi i Shqipërisë? Si mendoni ju në lidhje me rregullimin e ligjit në këtë pikë apo edhe të atij autoriteti që duhet të ketë KLSH-ja mbi Bankën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Bufi!

Do t'ju lutesha të gjithë deputetëve që t'i kursejnë pyetjet që lidhen me rastin konkret të vjedhjes, pasi është totalisht i shfazuar në kohë në detyrën që ka ushtruar zonja Baleta dhe mund të mos ketë përgjigje.

Fjalën e ka zonja Baleta.

Teuta Baleta – *A duhet të ketë kontroll fizik të punonjësve?*

Kur ne hynim në bankë, hynim nëpërmjet një zbuluesi metalik. Kjo ishte një lloj forme kontrolli. Ne e kemi testuar edhe efektshmërinë e funksionimit të këtij kontrolli, por prapë nuk ju jap dot rezultate të testimit.

Pse nuk është marrë parasysh trajnimi këtu?

Theksoj: vetëm për inspektorët e kontrollit. Unë fola për trajnimin e inspektorëve të kontrollit, që kërkova një shkollë profesionale për ta dhe duhet të kuptojmë që auditimi i brendshëm ushtrohet mbi një mjedis dinamik. Pra, edhe fryma e standardeve ndryshon. Sidomos pas krizës financiare që ndodhi në vitin 2000 ndryshoi tërësisht fryma se si kuptoheshin e zbatoheshin standardet dhe pas krizës financiare botërore akoma më shumë. Prandaj kërkohet trajnimi i vazhdueshëm.

Në manualin e inspektorit të kontrollit, që ne përgatitëm, e vendosëm si detyrim që të kishte minimumi 15 ditë trajnimi në vit për të, me qëllim që të ishte vazhdimisht në kontakt me të gjithë të rejtat

që ka profesioni për të përmbushur sa më me cilësi detyrën. Ndërkohë, kur unë kam filluar detyrën, inspektorët e kontrollit i kam gjetur me një ose dy ditë trajnim në vit mesatarisht, që janë të pamjaftueshme. Pra, kjo gjë u realizua. Ajo që nuk realizonim dot ishte shkolla sistematike e tyre për t'u njohur me standardet ndërkombëtare.

Argumentimi në fillim ishte që ky propozim u hodh në tender dhe dështuan procedurat e tenderit. Më pas nuk pata asnjë argumentim tjetër se pse nuk u realizua dot kërkesa ime për të trajnuar inspektorët e kontrollit.

Këtë do ta jap opinion të sinqertë, unë e kam konsideruar si një ndër përpjekjet për të kundërshtuar dhe për të cenuar punën cilësore të auditimit.

Për sa i përket certifikatës së sigurisë për individin, nuk është autoriteti i Bankës së Shqipërisë që e lëshon këtë certifikatë. Pra jo vetëm unë, por besoj askush tjetër në atë institucion nuk mund të japë përgjigje për këtë.

Sa janë marrë parasysh rekomandimet nga Kuvendi?

Duhet theksuar se inspektori i Përgjithshëm nuk i jep rekomandime Kuvendit. Ai raporton në Këshillin Mbikëqyrës dhe i jep rekomandime Këshillit Mbikëqyrës. Një pjesë e mirë e këtyre rekomandimeve nuk janë marrë parasysh, pra nuk është shprehur Këshilli Mbikëqyrës nëse duhen marrë ose jo parasysh dhe këtu duhet të sqarojmë një gjë: mosmarrja parasysh e një rekomandimi, nuk do të thotë se rekomandimi është i gabuar. Kjo do të thotë se drejtuesi e njuh riskun, e pranon ta ketë atë nivel risku dhe merr mbi vete njëkohësisht edhe përgjegjësinë.

Pra, edhe në qoftë se do të shprehej këshilli që nuk i pranon këto rekomandime, kjo nuk do të thotë se puna e Departamentit të Kontrollit ka qenë e gabuar dhe ka dhënë rekomandime të pasakta. Kjo thjesht vendos raportin e përgjegjësisë dhe të riskut ndërmjet drejtimit dhe strukturave të kontrollit.

Një pjesë e mirë e këtyre mbetën pa u zbatuar, mund të them, se sa për qind, unë i kam dhënë nëpër raporte dhe nuk i mbaj mend tani, por di që ka qenë një pjesë e konsiderueshme.

Cili mund të jetë rregullimi me Kuvendin?

Këtu më lejon të sqaroj një procedurë që ka pasur inspektori i Përgjithshëm me Kuvendin e Shqipërisë. Skandalet deri diku konsiderohen edhe si shkolla për të përmirësuar funksionimin e institucioneve.

Në vitin 2002, nëse mbahet mend, ka ndodhur një problematikë në Bankën e Shqipërisë, mbi bazën e së cilës u ndërmorën nisma për të shkarkuar guvernatorin dhe inspektorin e Përgjithshëm.

Pavarësisht si përfunduan ato nisma, ka pasur një nismë nga kryetari i Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, në drejtim të inspektorit të Përgjithshëm që i rekomandonte të informonte edhe Kuvendin e Shqipërisë për problematikat që ai haste gjatë procesit të auditimit.

Mbi atë bazë, nga viti 2003 e në vazhdim, ka vijuar informimi i Kuvendit të Shqipërisë dhe këto problematika i janë përcjellë edhe atij. Është një praktikë që unë e kam gjetur, dhe e theksoj, e kam vijuar dhe nuk ka absolutisht asnjë problem ligjor për ta vijuar këtë praktikë, madje nuk do t'ju referoj dot cilën bankë, por unë jam konsultuar edhe me inspektorin e Përgjithshëm të një banke tjetër qendrore, i cili gjithashtu raportonte në kuvendin e shtetit përkatës se si do të vepronte ai në një rrethanë të tillë, meqenëse ligji nuk shprehet. Pra nuk e pengon, por as nuk shprehet për modalitetin e informimit. Përgjigjja ka qenë e qartë: në asnjë rrethanë nuk mund të hidhen poshtë kërkesat e Kuvendit të Shqipërisë. Sigurisht që informimi do të bëhet mbi bazën e kufijve që do të vendos ligji. Pra unë nuk mund të jap informim në cilësinë e inspektorit mbi problematika që janë nën përgjegjësinë e inspektorit të Përgjithshëm. Mbi këtë bazë ka vijuar informimi. Këshilli i Mbikëqyrjes ka qenë i qartë, sepse Këshilli Mbikëqyrës i vitit 2002 është shprehur dakord jo me vendim, por është shprehur dakord për vijimin e informimit. Këshilli Mbikëqyrës kur unë kam kryer detyrën, nuk është shprehur. Pra si gjithmonë zgjidhte rrugën e mosshprehjes. Më tej nga sa kam marrë vesh nga mediat, këshilli aktual është shprehur kundër.

Kjo është situata.

Autoriteti i KLSH-së.

Duhet ta shprehë KLSH-ja nëse e ka të mjaftueshëm autoritetin për auditimin.

Nga praktika ime, ndoshta tani ka ndryshuar, KLSH-ja nuk ndërvepronte sa duhet me auditimin e brendshëm. Në kuptimin që nuk takohej, nuk pyeste për problematikën etj.

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Baleta!

Fjalën e ka Çuko.

Arben Çuko – Zonja Baleta, ju falënderoj për ekspozenë me nivel shumë të lartë profesional që na paraqitët këtu!

Nisur nga përvoja juaj si inspektore e Përgjithshme, unë kam dy pyetje:

A do ta konsideroni ju detyrim ligjor dhe funksional të inspektorit të Përgjithshëm për t'u paraqitur përpara komisionit për të dhënë shpjegime për çështje të caktuara?

E dyta, që nuk ka lidhje me çështjen konkrete për të cilën na tërhoqi vërejtjen edhe kryetari, por në seancën dëgjimore që organizuam ne si komision me guvernatorin e bankës, mua më bëri përshtypje

një shprehje e tij: nga 1 mijë arka, ai hajduti ka vënë dorë mbi 6 arka. A mund të di procedurat e inventarizimit të vlerave monetare? Konkretisht të këtij subjekti, të këtyre 1 mijë arkave. Në kohën tuaj ndoshta kanë qenë 500, nuk ka rëndësi sasia, unë jam i interesuar për procedurat e grupit të inventarit. A është i detyruar t'i inventarizojë të gjitha apo me përzgjedhje?

Faleminderit!

Teuta Baleta – *A është detyrim ligjor funksional për të dhënë shpjegime?*

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë sot jam paraqitur përpara jush, besoj se kjo ju jep përgjigje.

Procedurat e inventarizimit, a është i detyruar t'i bëjë të gjitha apo me përzgjedhje?

E theksoj edhe një herë, këto janë detaje të procedurave që unë nuk mund t'i mbaj mend përmendësh dhe nuk mund të shprehem, sepse nuk dua të rrezikoj. Gjatë dëshmisë sime shprehja pse ishte e nevojshme për inspektorët e kontrollit që të trajtoheshin me njohuri statistikore. Për një arsye shumë të rëndësishme: funksionet, proceset, aktivitetet mund të konsiderohen si të panumërta në Bankën e Shqipërisë nga pikëpamja fizike, nga pikëpamja sasiore dhe praktikisht është e pamundur që të vësh dorë në gjithçka në çdo moment. Për këtë arsye dhe për të rritur efektivitetin e punës së auditimit kërkohet që të përdoren teknika të përzgjedhjes së kryerjes së testimeve. Pra nëse ke 1000 dokumente për të kontrolluar, atëherë duhet të bësh një kampion të këtyre dokumenteve për të përcaktuar sa do të kontrollohen dhe me cilat tipare përfaqësimi, si dhe ky kampion auditimi duhet të jetë i tillë që të jetë sa më përfaqësues, me qëllim që të reduktojë në minimum riskun që gjatë auditimit të shpëtojnë problematika të rëndësishme.

Kjo bëhet duke pasur njohuri statistikore dhe kjo është arsyeja e nevojshme që teknika e përzgjedhjes duhet të jetë shumë mirë e studiuar.

A ka qenë kjo teknikë e përzgjedhjes së studiuar në momentet e inventarizimit, se inventarizimin nuk e bëjnë inspektorët e kontrollit? Inspektorët e kontrollit inspektojnë procedurat, qoftë të inventarizimit, të kontrolleve etj. Për këtë duhet të shprehen ata që e kanë bërë si procedurë dhe njëkohësisht në qoftë se jemi shprehur në raportet e auditimit, përsëri është informacion i klasifikuar.

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Baleta!

Zonja Kushi.

Evis Kushi – Unë doja një mendim nga ana juaj si eksperte e funksionimit të Bankës së Shqipërisë, por edhe të legjislacionit në këtë fushë, a duhet që guvernatori të mos jetë pjesë e Këshillit Mbikëqyrës?

Pra, guvernatori nga njëra anë dhe Këshilli Mbikëqyrës të jenë dy autoritete të pavarura. Si mendoni ju si eksperte, në qoftë se ne do të kemi pastaj nisma për të ndryshuar ligjin, apo kjo nuk e cenon mirëfunksionimin e punës?

Edhe diçka tjetër, në lidhje me pyetjen që bëra pak më parë, për përfshirjen e familjarëve të politikanëve në Bankën e Shqipërisë, unë nuk dua aspak që të paragjykoj profesionalizmin e tyre, madje për një pjesë të tyre jam në dijeni që janë vërtet profesionistë shumë të mirë, por pyetja ime lidhej më tepër me faktin nëse kjo e cenon pavarësinë e Bankës së Shqipërisë, apo jo?

Pra supozojmë sikur të gjithë ata janë profesionistë, a e cenon, apo jo?

Teuta Baleta – *Duhet të jetë guvernatori pjesë e Këshillit Mbikëqyrës?*

Ky është një problem i pazgjidhur, edhe teorikisht, edhe në praktikë. Ka plot modele dhe ka plot argumente pro dhe kundër. Mendimi im personal nga periudha që kam parë funksionimin, në Shqipëri, për hir të efektivitetit, punëve etj., përjashtimi i guvernatorit nga të qenit anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, do ta dobësonte rolin e guvernatorit dhe do ta vështirësonte, por ky është mendimi im personal që nuk jepet në cilësinë e inspektorit të Përgjithshëm. Atë e kam të formuar nga praktika e punës në Bankën e Shqipërisë, nga mënyra se si funksionojnë institucionet dhe tradita në Shqipëri, si dhe nga leximi i literaturës për këtë efekt.

Pra do të dobësonte drejtimin në ekzekutiv dhe duke dobësuar drejtimin në ekzekutiv do të krijonte atë rrethanë që institucioni do të ishte me dy koka, të cilat mund të mos merren vesh në drejtim, gjë që do ta fuste në ngërç institucionin dhe për rastet e Shqipërisë, fatkeqësisht, është më e mundshme të ndodhë kjo sesa të ndodh rrethana tjetër që një individë të ushtrojë, megjithëse ndodh, autoritetin e tij të plotë mbi këdo.

Gjithsesi, është më e lehtë që nëpërmjet elementeve të përgjegjshmërisë të kontrollohet rrethana kur ka një kokë institucioni sesa rrethana tjetër.

A cenon pavarësinë prania e të afërmve të politikanëve?

Këtë duhet ta zgjidhë Kuvendi, meqenëse institucioni, jo ju personalisht, ka deklaruar një pjesë të të afërmve të anëtarëve të Kuvendit të punësuar në Bankën e Shqipërisë. Mendoj se në konflikt interesit më tepër këtu është Kuvendi. Pra, Kuvendi në rastet kur diskuton çështjet e Bankës së Shqipërisë, të ligjeve, të raportimeve etj. mendoj se secili anëtar duhet të regojë në rrethana të tilla që të mos shkelë dispozitat e ligjit të konfliktit të interesit. Besoj se ai ligj vepron edhe mbi anëtarët e Kuvendit. Kjo është përgjigja ime.

Erion Braçe – Zoti Ndreu e ka fjalën.

Pjerin Ndreu – Zonja Baleta, në referimin tuaj keni ngritur tri probleme, të paktën që kam kapur unë: cenimi i pavarësisë në aspektin juridik, mungesa e burimeve njerëzore dhe kufizimi i aksesit të informacionit. Desha të di cili është autoriteti i rregullimit të këtyre problemeve, guvernatori apo Këshilli Mbikëqyrës?

Teuta Baleta – Këshilli Mbikëqyrës.

Pjerin Ndreu – Guvernatori nuk ka askes të rregullojë problematikën?

Teuta Baleta – Guvernatori e ka aksesin, por autoriteti përfundimtar...

Pjerin Ndreu – Më sqaro, të lutem!

E ka përgjegjësinë Këshilli Mbikëqyrës, apo guvernatori?

Teuta Baleta – Përgjegjësia fillon shkallë-shkallë. Së pari, që ndër ata që refuzuan fillimisht, duke shkelur ligjin, të japin informacione dhe pastaj në të gjitha shkallët eprore të tyre deri në Këshillin Mbikëqyrës. Përgjegjësia përfundimtare është e Këshillit Mbikëqyrës.

Pjerin Ndreu – Raportet tuaja i kalojnë ligjërisht direkt Këshillit Mbikëqyrës apo Parlamentit, apo të dyja variantet bashkë?

Sa informacione për problematikën janë administruar në Këshillin Mbikëqyrës ose në Parlament? Qëndrimin e mora vesh se çfarë qëndrimi është mbajtur, por sa herë është mbajtur qëndrim për problematikën që keni ngritur vetë?

Teuta Baleta – Atëherë, raportet ligjërisht i kalojnë Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Njëherësh me raporte vihen në dijeni edhe gjithë struktura ekzekutive, tek e cila është ushtruar auditimi, pra, njësia përkatëse, si dhe administratori përkatës, përfshirë dhe guvernatorin.

Sa herë janë çuar raportime, ka një rregullshmëri raportimi, pra, janë informuar strukturat ekzekutive sa herë që janë bërë auditivet, në përfundim të auditimit. Me një mesatare prej çdo tre muaj është informuar Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Për raste të veçanta është informuar edhe jashtë këtij raportimi të rregullt, kur ka pasur problematika. Dhe se sa herë me numër, nuk e mbaj mend, a është 20, a është 30, mund të jetë 50.

Erion Braçe – Ok. Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ndreu, urdhëroni!

Pjerin Ndreu – Gjatë auditimit tënd, në kohën kur ke qenë ti, në njësinë ku ka ndodhur vjedhja, ti vetë ke evidentuar ndonjëherë ndonjë problem? Dhe, po në këtë njësi, sepse ke punuar me tjetër

Këshill Mbikëqyrës, por me të njëjtin guvernator, je penguar ndonjëherë nga guvernatori ose është ushtruar trysni që të mos ta kryesh kontrollin si duhet në këtë njësi ku sot është edhe problemi?

Erion Braçe – Zonja Baleta, ju lutem, një sekondë!

Edhe një herë, të mos ngatërrojmë vjedhjen që ka ndodhur, kohën e të cilës ende nuk e dimë...

Pjerin Ndreu – Jo, jo, po them për kohën e saj.

Erion Braçe – Zoti Ndreu, edhe një herë, të mos ngatërrojmë vjedhjen kur ka ndodhur, apo vjedhjen që ka ndodhur me detyrat e tjera në departamentin e Emisionit, mos ta ngatërrojmë këtë gjë!

Pjerin Ndreu – Po është audituese. Në kohën kur ka audituar në këtë njësi ka evidentuar ndonjëherë ndonjë problem, apo jo?

Erion Braçe – Zoti Ndreu, edhe një herë, është tjetër gjë pyetja: a ka pasur auditive në departamentin e Emisionit, cila ka qenë problematika në të, dhe është tjetër gjë lidhja e këtij departamenti me vjedhjen. Janë dy gjëra komplet të ndryshme.

Për vjedhjen, po jua them unë...

Pjerin Ndreu – Unë e di se shkaku i këtij takimi ky është. Shkaku i takimit është një vjedhje që ka ndodhur në një njësi të caktuar të bankës. Në atë njësi, ka pasur ndonjë problem në auditim, sepse është audituar?

Erion Braçe – Zoti Ndreu, edhe një herë, do të më duhet të riformuloj pyetjen tuaj: zonja Baleta, ka pasur problematika në departamentin e Emisionit gjatë ushtrimit të mandatit tuaj? Kaq, deri këtu!

Teuta Baleta – E theksoj edhe një herë, problematikat e evidentuara në të gjitha njësitë që ne kemi audituar, funksione, procese etj., janë raportuar dhe ato janë në raportet e auditimit, të cilat janë të depozituara në arkivin e Bankës së Shqipërisë. Besoj të jenë të plota atje në arkivën e Bankës së Shqipërisë.

Erion Braçe – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Dusha!

Luan Duzha – Për ta saktësuar: a është detyrë ligjore e auditit të brendshëm kontrolli fizik i arkës stok ?

Teuta Baleta – Nuk është detyrë ligjore kontrolli fizik i arkës, por është detyrë të bëjë testim në goftë se dyshon ose shikon që procedurat e kontrollit...

Erion Braçe – Mjaftueshmërinë e kontrollit.

Luan Duzha – A është kryer ndonjëherë në kohën tuaj ky testim?

Teuta Baleta – Nuk mund ta them.

Erion Braçe – Domethënë, edhe një herë, zoti Dusha, në qoftë se edhe unë e kuptova pyetjen tuaj, sepse është përsëritur disa herë dhe është marrë një përgjigje: audituesit merren drejtpërdrejt me mjaftueshmërinë e kontrollit që është ushtruar atje. Pra, nuk është detyrë e drejtpërdrejtë e audituesit kontrolli fizik dhe që grupet... Audituesi po, shikon pikërisht si ka funksionuar kjo gjë dhe kontrollin mbi këtë gjë.

Luan Duzha – Si e zbulon audituesi?

Erion Braçe – Është detyra e ekzekutivit kjo gjë, nuk është detyra e audituesit.

Luan Duzha – Auditimi i brendshëm nuk e zbulon kurrë vjedhjen e arkës stok.

Erion Braçe – Nuk është kështu.

Ka pyetje të tjera nga kolegët deputetë?

Nuk ka.

Atëherë, zonja Baleta, shumë faleminderit për prezencën tuaj në Komisionin e Ekonomisë! Faleminderit dhe për të gjitha shpjegimet që bëtë përtej veprimtarisë së punës tuaj, veçanërisht ato që na vlejné edhe ne si komision i ekonomisë për të përmirësuar punën tonë në raport qoftë me Bankën e Shqipërisë, por edhe me organet drejtuese të saj!

Natyrisht, faleminderit edhe për mendimet që dhatë në raport me atë iniciativë që edhe mund të materializohet për ndryshimet në ligjin “për Bankën e Shqipërisë” në ato aspekte që veçanërisht gjatë viteve të fundit kanë reflektuar edhe problematika të caktuara!

Shumë faleminderit!

Jeni e lirë të largoheni!

Komisioni vazhdon, mbetet në pritje të inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.09.2014, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Agron Çela, Andrea Marto, Arben Çuko, Ervin Koçi, Evis Kushi, Gjovalin Kadeli, Ilir Xhakolli, Blerina Gjylameti, Gledjon Rehoveci, Luan Duzha, Majlinda Bufi, Paulin Sterkaj, Pjerin Ndreu dhe Përparim Spahiu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Koço Kokëdhima, Edmond Spaho, Ridvan Bode, Albana Vokshi, Dashamir Shehi, Florion Mima, Jorida Tabaku, Liljana Elmazi, Sherefedin Shehu, Igli Cara.

E ftuar:

Elivar Golemi – inspektor i Përgjithshme i Bankës së Shqipërisë.

Erion Braçe – Jemi në pritje të inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

(Në pritje të inspektoreve të Përgjithshme.)

Ky është rasti kur institucioni më i lartë kushtetues në Republikën e Shqipërisë detyrohet të presë një punonjës të Bankës së Shqipërisë, për më tepër i zgjedhur nga Kuvendi.

(Në pritje të inspektoreve të Përgjithshme.)

Për fat të keq, nuk është sfidë ndaj meje, por ndaj autoritetit të Kuvendit. Shumë mirë që e dokumentoni edhe këtë fakt. Kjo është gjendja institucionale në Bankën e Shqipërisë.

(Në pritje të inspektoreve të Përgjithshme.)

Siç ju e dini, Komisioni i Ekonomisë në dy seanca rresht ka kërkuar që pranë këtij komisioni të paraqitet inspektorja e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë dhe për të dhënë shpjegime. Dua të sqaroj qartësisht edhe opinionin publik, edhe kolegët deputetë se ky komision nuk ka kërkuar asnjëherë dëshmi në kuptimin penal të saj nga asnjë prej autoriteteve drejtuese të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Këshillin Mbikëqyrës, inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë apo edhe ish-inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, që ju sapo e ndoqët. Pra, në dy seanca rresht i kemi kërkuar inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë që të jetë prezent në këtë komision për të dhënë shpjegime lidhur me përmbushjen e detyrës së saj, në respekt të nenit 54, pika 3 e ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, asgjë më shumë sesa kaq.

Natyrisht që kërkesa jonë është mbështetur qartësisht në nenin 80, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që besoj unë, për shkak se është akti më i lartë kushtetues në këtë vend, duhet të jetë parësor, themelor, mbi ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” për të gjitha autoritetet drejtuese të Bankës së Shqipërisë. Neni 80, pika 3 thotë qartësisht: “Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për atë që sa u lejon ligji.” Asgjë më shumë se kaq nuk kemi kërkuar ne, apo nuk kemi konsumuar ne. Pra, kërkesa që inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë të vijë para këtij komisioni për të dhënë shpjegime mbi përmbushjen e detyrës së tij ligjore është e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 80, pika 3. Refuzimi i përsëritur i kësaj kërkesë shkel rëndë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Së dyti, në zbatim të këtij neni të Kushtetutës, Rregullorja e Kuvendit, në nenin 36 “Seancat dëgjimore publike” ka përcaktuar qartë në pikën 1: “Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarët e Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupe të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar ta realizojë seancën dëgjimore sipas përcaktimeve të bëra

në këtë nen, në rast se 1/3-ta e gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar dhe me shkrim.” Ka vetëm një kusht: është më shumë se 1/3-ta e anëtarëve që e kanë kërkuar pikërisht seancën dëgjimore me inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Refuzimi i përsëritur për t’u paraqitur para këtij komisioni është në shkelje të rëndë të nenit 36 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që duhet të ishte dokumenti i dytë bazë në referencën e veprimtarisë, në raport me Kuvendin, për inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, që është një institucion, individ, funksionar i lartë, apo drejtues i Bankës së Shqipërisë, që emërohet, zgjidhet dhe shkarkohet vetëm nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe nga kurrkush tjetër, në dallim nga pjesa tjetër ekzekutive dhe mbikëqyrëse e Bankës së Shqipërisë, që është Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Vijmë tek elementi tjetër. Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” në nenin 2 të tij thotë qartësisht: “Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë.” Më ndjeni për termin “Kuvend Popullor”, se është “Kuvendi i Republikës së Shqipërisë”, por ky është përcaktimi në ligj për shkak të vjetërsisë që ka në kohë ligji. Pra, Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë. Refuzimi i përsëritur është në shkelje të hapur të nenit 2 të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”.

Për të vazhduar më tej me nenin 41, që përcakton qartë se cilat janë organet drejtuese të Bankës së Shqipërisë: “Banka e Shqipërisë organizohet, drejtohet dhe e kryen veprimtarinë e saj nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës, administratorëve, që janë Guvernatori dhe dy zëvendësguvernatorët, si dhe personelit, siç përcaktohet në këtë ligj.” Ky nen është i lidhur me nenin 54 të po këtij ligji, në pikën 1 të cilit përcaktohet qartë se paga e Inspektorit të Përgjithshëm, shpërblimet suplementare, duke përfshirë çdo lloj kompensimi, si dhe trajtimet e tjera njësohen me ato të zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë. Pra, pika 1 e nenit 54, kur bën fjalë qartësisht për statusin që ka inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë, e njëson me të zëvendësguvernatorit të Bankës së Shqipërisë, që përfshihet sipas nenit 41 ekzaktësisht në rangun e drejtuesve të lartë, të cilët, sipas Kushtetutës dhe Rregullores, që ju lexova pak më sipër, hyjnë në rangun e drejtuesve, të cilët kanë detyrimin t’i përgjigjen komisionit përkatës të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në fund, përsëri neni 54 përcakton fare qartë faktin se inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë propozohet, emërohet dhe shkarkohet vetëm me vendim të Kuvendit dhe me asgjë tjetër. Pra, që është nomenklaturë totale e Kuvendit, veçanërisht e komisionit përgjegjës për Bankën e Shqipërisë. Dua t’ju them se pika 3 përcakton detyrat e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, për të

cilat ne jemi angazhuar dhe kërkojmë shpjegime pikërisht nga inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë. Kjo është baza ligjore në bazë të së cilës ne kemi kërkuar që inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë të paraqitet pranë këtij komisioni.

Refuzimi i përsëritur i zonjës që bën detyrën e inspektorit të Përgjithshëm të Kuvendit në raport me këtë institucion, natyrisht që ka shkelur Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”. Në anën tjetër, refuzimi që inspektori i Përgjithshëm i bën këtij institucioni tregon standardin e ulët institucional të Bankës së Shqipërisë në raport me Kuvendin e Shqipërisë.

Dua t’ju them edhe një fakt për shkak se jeni vënë në dijeni edhe dje gjatë orëve të vona, reflektuar edhe shqetësimin e madh të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë me disa arsye ligjore që kanë ardhur nga Banka e Shqipërisë që justifikojmë mosprezencën e inspektores së Përgjithshme. Ligji në asnjë nen nuk i jep të drejtën inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë të refuzojë të paraqitet para Komisionit të Ekonomisë së Kuvendit. Përkundrazi, duhet të të paraqitet këtu dhe brenda normave që parasheh ligji t’i japë këtij komisioni informacionin e kërkuar.

Sapo më kanë bërë me dije nga protokolli se ka ardhur një letër në bazë të së cilës inspektori i Përgjithshëm përsëri refuzon të paraqitet në Komisionin e Ekonomisë, duke u bazuar në disa prej neneve, të cilat, në fakt, nuk kanë lidhje fare me atë që parashikojnë Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligji “Për Bankën e Shqipërisë”, ashtu si në fund fare, edhe një herë, dhe ky është absurdi në dy ditë rresht, që nga njëra anë thuhet: “Unë nuk paraqitem para komisionit”, por përsëri merret angazhimi për t’iu përgjigjur me shkrim në kohën më të shkurtër të mundshme çdo kërkesë për informacion të çdo deputeti të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ky është një problem shumë i madh. Pra, nga njëra anë thotë se në bazë të këtyre neneve nuk i përgjigjem Kuvendit dhe në anën tjetër, duke mos iu referuar asnjë neni, thotë: “Unë i përgjigjem me shkrim secilit prej deputetëve të Kuvendit, madje edhe në kohën më të shkurtër, pavarësisht se ne kemi dy ditë që po e presim që të vijë ta japë këtë përgjigje këtu. I gjithë ky argumentim që tenton të jetë ligjor është rrëzuar me një akt të vetëm. Ju tregova në fillim të seancës procesverbalin e seancës dëgjimore me dyer të mbyllura të këtij komisioni me Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë menjëherë pas vjedhjes në Bankën e Shqipërisë. Pa e kërkuar ne, pa e kërkuar asnjë prej anëtarëve të komisionit, pa e kërkuar Kuvendi si institucion, zonja inspektore e Përgjithshme e Bankës së Shqipërisë ka qenë prezente me vullnetin e saj, jo tonin si komision dhe jo të Kuvendit, madje gjatë gjithë seancës jo vetëm konsultonte Guvernatorin, por në anën tjetër tentonte të përgjigjej edhe përkundrejt anëtarëve të komisionit për pyetje të caktuara që secili prej kolegëve adresonte përkundrejt Guvernatorit dhe jo inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë. Pra, e gjitha kjo arsye, ta

quajmë ligjore, jo vetëm që bie ndesh me Kushtetutën, me Rregulloren dhe me nenet e posaçme të ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, por në anën tjetër është rrëzuar pikërisht nga ky fakt: nga fakti i qartë i prezencës së zonjës, madje edhe pa kërkesën e Komisionit të Ekonomisë këtu në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, në komisionin përgjegjës, që është ai për Ekonominë dhe Financat. Ky është një problem shumë i madh dhe natyrisht ka vënë në diskutim autoritetin kushtetues të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Referencat kushtetuese jua lexova dhe natyrisht ajo referencë kushtetuese bazohet në një nga parimet bazë të funksionimit të Kuvendit: kontrollin përkundrejt çdo institucioni, duke përfshirë institucionet ekzekutive dhe institucionet e tilla kushtetuese, siç është Banka e Shqipërisë, si institucion kushtetues i pavarur që përgjigjet drejtpërdrejt para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte jemi. Një diskutim të parë e kemi bërë edhe dje, edhe publik. Unë mendoj se hapësirat ligjore, për më tepër në kushtet kur edhe kërcënohemi, duke treguar që raportit e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë janë sekret bankar dhe i rezervuar. Ndërkohë, për kuriozitetin tuaj, mund t’ju tregoj sesi klasifikohet ky sekreti me shkrim dore. Ja ky është sekret i rezervuar. Ky është klasifikimi. Në kushtet kur, siç u verifikua edhe nga seanca e mëparshme, këtij Kuvendi i janë mohuar për vite të tëra më radhë raportet e inspektimit të Bankës së Shqipërisë, në mënyrë të padrejtë, të pandershme dhe, mbi të gjitha, në mënyrë të paligjshme, kur praktika e dorëzimit të raportit të inspektorit të Përgjithshëm, siç e dëgjuat më përpara, ka ekzistuar për dorëzimin e tyre në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në kushtet kur Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur me votë, siç referohet në këto raporte dhe ky s’është as sekret bankar dhe as konfidencial, pra, ka vendosur me votë që Kuvendit t’i fshihen raportet e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Mendoj që të procedojmë më tutje. Propozimi im është që ky Komision të autorizojë kryetarin që me anë të një raporti të vërë në dijeni Konferencën e Kryetarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për të marrë miratimin dhe për të nisur procedimin me shkarkimin e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë. Në bazë të nenit 54 të ligjit për Bankën e Shqipërisë, që referon në nenin 47 të po këtij ligj, ku thuhet qartësisht që vetëm Kuvendi e shkarkon inspektorin e Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, në rast se verifikohet njëri prej shkaqeve të parashikuar në nenin 47 të këtij ligji. Dhe shkak kësaj radhe është: shkelje e Kushtetutës, shkelje e ligjit, shkelje e Rregullores së Kuvendit, që përmbledhen të gjitha në një zë, në thyerje të rëndë të etikës. Dhe natyrisht për shkak të problematikës që paraqesin raportet ku pranohet edhe inspektori i Përgjithshëm në moskryerjen të paktën e një detyre: kontrollit dhe lëshimit të certifikatës për tabelat periodike financiare të Bankës së Shqipërisë, verifikuar

edhe nga Këshilli Mbikëqyrës. Janë të gjitha kushtet për të nisur këtë procedim për shkarkimin e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Kërkoj nga Komisioni autoritetin për t'i paraqitur Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me shkrim dhe personalisht një raport për këtë pjesë, sepse do të ketë një raport të përgjithshëm, në fund të këtij procesi, për situatën institucionale në Bankën e Shqipërisë. Natyrisht, do të jenë edhe rekomandimet tona për të nisur një proces ligjor për të përmirësuar ligjin për Bankën e Shqipërisë. Por ai është raporti në fund të këtij procesi. Flasin për një raport paraprak për këtë situatë të krijuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për mospërbushjen e detyrës edhe nga inspektori i Përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë, për të marrë Konferenca e Kryetarëve autoritetin për të nisur procedurën për shkarkimin e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Urdhëroni, zoti Koçi!

Ervin Koçi – Unë jam dakord me propozimin tuaj. E thashë që ditën e djeshme. Unë doja të thosha që, duke parë shkresën, se sot nuk i kemi hyrë akoma inspektorit të Përgjithshëm që deklaronte se: “Nuk jam e autorizuar të përfaqësoj Bankën e Shqipërisë”: në fakt, ajo përfaqëson Kuvendin e Shqipërisë, sepse është atje për të audituar se si funksionon Banka e Shqipërisë, për të informuar Këshillin Mbikëqyrës, po pa diskutim për të informuar edhe Kuvendin. Nëse ajo niset nga ajo që raportet e auditimit ia çon Këshillit Mbikëqyrës, është normale, sepse çdo raport auditimi i çohet personit juridik që administron atë institucion. Besoj se jo vetëm që nuk është etike, por është një fyerje e rëndë për Kuvendin e Shqipërisë, për ne që përfaqësojmë qytetarët që ajo refuzon të vijë, kur edhe nëse nuk shkonte diçka në kërkesën tonë, ajo mund të refuzonte të përgjigjej, siç ndodhi me atë që ishte thënë përpara. Vëmë në dijeni median se seanca dëgjimore nuk kishte aspak në gjykim ngjarjen e rëndë, por ka qenë me këtë tematikë: përmbushjen e detyrës së ngarkuar me ligj, problemet në përmbushjen e saj, problematikat e zbuluara dhe të raportuara në funksionimin e Bankës së Shqipërisë, si mjaftueshmëri e kontrollit të brendshëm të institucionit. Pra, për të parë se si funksiononte inspektimi në këtë institucion dhe çfarë mund të përmirësonim në të ardhmen.

Mendoj se bashkohen të gjithë anëtarët e Komisionit për të vendosur në vend edhe dinjitetin e parlamentit.

Erion Braçe – Zonja Bufi.

Majlinda Bufi – Faleminderit!

Nuk mendoj se ka më vend për të vazhduar me diskutime. Propozimin e kryetarit mendoj që ta kalojmë direkt në votim.

Faleminderit!

Erion Braçe – Propozimi është për t'i dhënë autoritetin kryetarit të Komisionit për të paraqitur shqetësimin në Konferencën e Kryetarëve dhe për të marrë prej saj nisjen e procedurave. Do të kthehem këtu për të verifikuar këto që thamë në procedurën e nisur për shkarkimin e inspektorit të Përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Mbledhja mbyllet këtu.

Ditën e hënë vazhdon seanca dëgjimore me dy anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Me të parin, në orën 10:00.

Me të dytin, në orën 11:30.

Komisioni të qëndrojë.

MBYLLET MBLEDHJA